

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Skandali me Vlorë Hysenin, ish-ministri Vengu në "Koha Jonë-Debat": S'ka shkas për festën e prangave, as për gjyqe publike
ADRESA	https://kohajone.com/lajme/skandali-me-vlora-hysenin-ish-ministri-vengu-ne-koha-jone-debat-ska-shkas-per-festen-e-prangave-as-per-gjyqe-publike/
BURIMI	kohajone.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 19:00:43 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 18:00:11 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	50f4f0943210b257efd1ccff0608db8daa6f68d991bad8164bd958a3b6b91d66
TEKSTI	614c00e9d06d2d30f6079aaa4a180791ac1d9aeaf958174a96e2824ad0b0c79b
PAMJA	e3657230dcd0789879f429266763a9ca31dacca018fada185f31808632835721

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	cfc7ae9698855424b48bf767c0981e8c5a7310bb5e47d5a956b717afc7b0b10c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr të eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/cfc7ae9698855424b48bf767c0981e8c5a7310bb5e47d5a956b717afc7b0b10c>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Skandali me Vlora Hysenin, ish-ministri Vengu në "Koha Jonë-Debat": S'ka shkas për festën e prangave, as për gjyqe publike

DEBAT LAJME E MËRKURË, 23 SHTATOR 2026 20:00




Ish-ministri i Mbrojtjes dhe deputeti i PS-së, Pirro Vengu, i ftuar këtë mbrëmje në emisionin "Koha Jonë Debat" nga Nikoll Lesi, u pyet nëse është nën hetim nga SPAK. "Në dijeninë time, jo", u përgjigj Vengu, duke shtuar se edhe nëse një zyrtar hetohet, kjo nuk do të thotë se është fajtor. Vengu komentoi edhe lajmin mbi skandalin në SHISH me tashmë ish-drejtoreshën Vlora Hysenin, duke kritikuar atë që e quajti festa e prangave. "Hetimi i pushtetit nuk do të thotë dështimi i shtetit. Nuk ka shkas as për festën e prangave, as për gjyqe publike", deklaroi deputeti socialist.

Lesi: Tani mazhoranca pati një goditje që ishte goditje e madhe sipas opinionit publik, ku drejtuesja e shërbimit sekret u arrestua. Çfarë zien në këtë kazanin e mazhorancës? Erjon Braçe del në anën tjetër që dua kryetar bashkie. Elisa Spiropali thotë dua ndryshim të PS. Drejtuesja e SHISH-it arrestohet. Ish-zv/kryeministria Balluku është në hetim. Pra ka shumë ish-ministra që janë në hetim, kanë probleme. Ta bëj pyetje direkte. Në fakt është pyetje thartë. Po megjithatë po bëj. Kjo është studio emision. Ke pranuar. Ju jeni në hetim në SPAK?



Koha Jone

Na ndiqni në YouTube




Vengu: Në dijeninë time JO, por edhe sikur të isha padyshim që detyrat publike, shërbimi publik nënkupton në një republikë funksionale edhe mundësinë që të hetohesh. Nuk ka asnjë gjë të keqe. Dhe do shkoja me qetësinë që sjell besimi te drejtësia e vendit tim. Kështu që po edhe sikur të jesh në hetim, nuk do të thotë që je dënuar dhe nuk do të thotë që ke bërë diçka të paligjshme.

Përkundrazi unë gjykoj që shumë vite Nikoll kemi pritur që të forcojmë institucione që hetonin pushtetin, por kam bindjen gjithashtu që hetimi i pushtetit nuk do të thotë dështimi i shtetit. Ju përmendët një sërë çështjesh, unë kam qenë gjithmonë i parimit që nuk duhet ngatërruar gabimet e institucioneve me shtetin. Nuk duhen ngatërruar akuzat me një kulturë linçimi.

Përmendët rastin e djeshëm, pashë me shumë vëmendje të gjithë debatin publik që shpërtheu për këtë çështje dje, dhe më vjen keq që rinisi pak ajo që unë do ta quaja festa e prangave dhe nuk gjykoj që në një republikë të maturuar siç besoj që ne kemi filluar të jemi tani, duhet të vetëkënaqemi dhe nuk ka shkas as për festën e prangave, as për gjyqe publike, sepse pashë që giotina publike fillon edhe bie shpejt menjëherë për kështu lloj rastesh.

LAJMET KRYESORE



Kur sekretet e shtetit përfundojnë në krevatin e biznesmenit



Ish-ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu te Nikoll Lesi: Nuk ka ministra hijet Balluku-lokomotivë shtetformuese!



Sekretet e Vlora Hysenit për biznesmenin, eksperti i sigurisë: Korrupsion apo spiunazh, kjo çështje është tërmet



"Kush na e bëri këtë, duhet të paguaje", bisedat e Vlora Hysenit me Ergys Agasin. SPAK dyshon për lidhje personale



Debate PD – PS te Komisioni i Ligjeve për arrestin e Vlora Hysenit. Korreshi: O bosa, ka rënë shteti

TË PËRZGJEDHURA



Ish-ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu te Nikoll Lesi: Nuk ka ministra hijet Balluku-lokomotivë shtetfo...



Sukses i menjëhershëm për Muse të Metës: Mjeti i AI tejkalon rivalët si ChatGPT dhe Claude



Inteligjenca artificiale mund të jetë më e rrezikshme se bomba atomike. Robotët e vitëve 2030, 2040, 2...



Hamilton mohon kategorikisht: "S'kam kërkuar ndryshime stafi te Ferrari"



Klopp thërret 44 lojtarë për Gjermaninë: "Krenaria kombëtare të mos u besohet njerëzve të gabuar..."

MË TË LEXUARAT



ETIKETA NIKOLL LESI PIRRO VENGU SISH VLORA HYSENI

MË SHUMË NGA DEBATI



Edmond Spaho në "Koha Jonë-Debat": PD duhet të kërkojë nj...

Shpërthen Erion Braçe te Nikoll Lesi në KOHA JONË-DEBAT: Nuk votoj ka...

Erion Braçe në Koha Jonë-Debat: Nuk votoj kandidat të "njoftuar..."



Protesta do konturohet si parti politike? Fatbardh Kadilli: Rreziku ë...



Fatbardh Kadilli në "Koha Jonë-Debat": Protesta ka shkund...



Rreziku i Protestës...

LAJMET E FUNDIT



Analiza e Filip Çakulit: Vlora Hyseni dhe misteri i certifikatës së sigurisë!

10 MINUTA MË PARË



Shpëtim Aliu kapet në Rusi, koordinator i grupeve kriminale shqiptare

11 MINUTA MË PARË



Berisha ngre akuzat për Vlorën Hyseni: SPAK e mbbron, nuk e cilëson pjesë të grupit kriminal

14 MINUTA MË PARË



116 ditë protestë, Sidorela
Vatnikaj: Nga Agasi te Tahiri,
korrupsioni është bërë me
urdhër të Ramës

36 MINUTA MË PARË

Vengu mohon akuzat e
Ahmetajt për trafik ar*ësh: Të
pabazuara dhe të ekzagjeruara.
Shteti shqiptar nuk negocion
në hije

38 MINUTA MË PARË

116 ditë protestë, Arben Kola
thirrje SPAK: Vepro me dorë të
hekurt ndaj çdo politikani që ka
vjedhur shqiptarët

51 MINUTA MË PARË

MË SHUMË LAJME TË FUNDIT >

KOHA JONE

Gazeta "KOHA JONE" themeluar si e pavarur më datë 11 Maj 1991

Botues: Nikoll LESI. Adresa e redaksisë: Rruga "Samë Frasheri", Pallatet e Aviacionit të Vjetër Nr. 2, TIRANA - ALBANIA

TË FUNDIT

LAJME

SPORTI

EKONOMI

EDITORIAL

WEBTV

AKTUALITET

RAJONI

KOSOVA

BOTA

TEKNOLOGJI

SHOWBIZ

SHËNDETI

SOCIALE

TURIZËM

KURIOZITETE

KULTURA

HISTORIKU

KONTAKT

BOTUES & DREJTOR: Nikoll LESI

KRYEREDAKTOR: Daniel MUÇAKU

ZV/KRYEREDAKTOR: Redjon SHTYLLA

BORDI: Elsa KAMBERI, KRYETARE

NIPT: J71425013C



NDËRTUAR DHE MIRËMBAHET NGA

SD

© 2024 KOHA JONE. All rights reserved.

PRIVACY POLICY

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.